



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Nr. 463/2 Prot.

Datë 08.07.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Fatmir Xhafaj

Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar

I nderuar z. Xhafaj,

Në përgjigje të shkresës suaj, me lëndë “Ftesë për bashkëpunim”, prot., 2578, datë 28.06.2024, protokolluar me tonën me nr.463/1 prot., datë 01.07.2024, si dhe në kuadër të bashkëpunimit dhe arritjes së qëllimit kryesor të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, Autoriteti i Konkurrencës shpreh gatishmërinë për të kontribuar pranë këtij komisioni me ekspertizën e nevojshme dhe të dhëna e dokumenta të ndryshëm të hartuar nga institucioni ynë.

Në kuadër të ftesës së marrë, po citojmë më poshtë dokumentacionin që Autoriteti i Konkurrencës do dërgojë në rrugë elektronike në adresën e sugjeruar: KomisioniPosacem@parlament.al

- Rregullore e Brendshme “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Konkurrencës”;
- Udhëzim “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e Ligjit 9221/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”;
- Udhëzim “Mbi Konfidencialitetin dhe Aksesin në Dosje”;
- Udhëzim “Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket ceshtjeve të reja ose të pazgjdhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” për raste individuale”;

- Udhëzim “Mbi praktikat më të mira për dorëzimin e provave me karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave, në rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e neneve 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar si dhe në rastet e përqendrimeve”;
- Udhëzim Nr.5, datë 18.03.2020 “Mbi konkurrencës në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”;
- Udhëzim “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar” ;
- Udhëzim Nr.3, datë 26.06.20219 “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.”;
- Manual i procedurave antitrust;

Informacioni i mësipërm ka lidhje të drejtëpërdrejtë me forcimin e mëtejshëm të zbatimit të ligjit, duke integruar praktikat, udhëzuesit dhe rekomandimet e Bashkimit European apo institucioneve të ndryshme të BE-së.

Duke Ju falenderuar edhe një herë për ftesën, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të mëtejshëm.

Me konsideratë,

